



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008 dhe nenit 40 pika h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës propozon:

Në mbështetje të nenit 12 dhe 17 Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, dhe neneve 9 dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës \_\_\_\_\_ 2024, të miratojë këtë:

### PROPOZIM

#### VENDIM PËR MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT KUNDËR BRAKTISJES DHE MOSREGJISTRIMIT TË SHKOLLËS 2024-2026

##### Neni 1

**MIRATOHET**, Plani i veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës 2024-2026 i Komunës së Lipjanit.

##### Neni 2

Qëllimi i miratimit të këtij Plani është koordinimi i veprimeve ndërinstitucionale dhe ngritja e kapaciteteve në nivelin lokal dhe shkollor në zbatim të detyrimeve ligjore për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës, duke rritur përfshirjen e fëmijëve në arsim dhe zvogëlimin e braktisjes.

##### Neni 3

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani i Veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës 2024-2026 i Komunës së Lipjanit .

##### Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Arsim .

##### Neni 5

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës .

## Arsyetim

Baza ligjore për të miratuar këtë Propozim - Vendim është e përcaktuar me dispozitat e nenit 12 dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 si dhe neneve 9 dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021.

Qëllimi i miratimit të këtij Plani është koordinimi i veprimeve ndërinstitucionale dhe ngritja e kapaciteteve në nivelin lokal dhe shkollor në zbatim të detyrimeve ligjore për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës, duke rritur përfshirjen e fëmijëve në arsim dhe zvogëlimin e braktisjes.

Projekt-Plani i veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës 2024-2026 i Komunës së Lipjanit, është hartuar nga grupi punues ,ka qenë në konsultim publik dhe përkitazi me këtë është mbajtur edhe debati publik konform dispozitave përkatëse ligjore.

Nga të cekurat më lartë kërkojmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e këtij Propozim-Vendimi.

1Nr. 610/01-29086  
Lipjan, Më 18.06.2024

KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT

OPŠTINA LIPLJAN

MUNICIPALITY OF LIPJAN

**PLANI I VEPRIMIT KUNDËR BRAKTISJES DHE MOSREGJISTRIMIT TË  
SHKOLLËS**

**2024-2026**

---

## Përmbajtja

Lista e shkurtesave .....	.....
Hyrje .....	.....
Konteksti.....	.....
Qëllimi i planit të veprimt.....	.....
Objektivat .....	.....
Shtojca.....	.....

## Shkurtesat

---

<b>MASHTI</b>	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
<b>DKA</b>	Drejtoritë Komunale të Arsimit
<b>SMIA</b>	Sistemi i Menaxhimit të Informacioneve në Arsim
<b>EPRBM</b>	Ekipi për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit
<b>KN</b>	Këshilli i nxënësve
<b>KP</b>	Këshilli i prindërve
<b>KPAK</b>	Komiteti i Prindërve të Arsimit të Kosovës
<b>QPS</b>	Qendra për Punë Sociale
<b>OJQ</b>	Organizatë Joqeveritare
<b>UNICEF</b>	Fondi Ndërkombëtar për Fëmijë i Kombeve të Bashkuara
<b>ECMI</b>	Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve

## **HYRJE**

---

Janë një varg konventash dhe standardesh ndërkombëtare, të cilat kërkojnë qasje dhe mundësi të barabartë në arsim cilësor, prandaj shteti ka detyrim të ndërmarr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar të drejtën e arsimit për të gjithë qytetarët e vet pa dallim gjinie, etnie, aftësie e gjendje tjetër.

Meqë po flasim për shkollat dhe nxënësit/ fëmijët e arsimit parauniversitar, po i referohemi ekskluzivisht **Konventës për të Drejtat e Fëmijës**, si traktati që i mbulon në mënyrë gjithëpërfshirëse të drejtat e fëmijës në çdo cep të botës. Duke u thirrur në parimet bazë të kësaj konvente, shtetet orientojnë politikatat nacionale, prandaj ato janë bazamenti i të drejtave universale për çdo fëmijë/ individ: **Mosdiskriminimi, Pjesëmarrja, Interesi më i lartë i fëmijës dhe Zhvillimi i potencialit të plotë.**

Bazuar në këto parime, institucionet arsimore duhet të kujdesen për pjesëmarrje dhe gjithëpërfshirje në arsim cilësor, duke siguruar zhvillimin e fëmijëve brenda potencialit të plotë.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës (Nenin 47) dhe legjislacioni i arsimit garantojnë të drejtën e arsimit për të gjithë pa dallim gjinie, etnie, aftësie a gjendje tjetër, duke pasur për bazë të drejtat e njeriut/ fëmijës.

Ligjet aktuale: Ligji për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme, Ligji për Arsimin Parauniversitar, Ligji për Arsim dhe Aftësim Profesional, Ligji për arsimin dhe aftësimin për të rritur, Ligji për Inspeksionin e Arsimit në Kosovë, Ligji për Arsimin në Komunitat e Republikës së Kosovës, etj, bashkë me aktet nënligjore përcjellëse adresojnë mundësitë e barabarta dhe qasjen gjithëpërfshirëse në arsim cilësor.

Barrierat e natyrave të ndryshme brenda sistemit arsimor, sidomos ato të qasjes në arsim, ndërlidhur me faktorët e shumtë individual, familjar, shoqëror me kontekste të ndryshme sociale, ekonomike, shëndetësore e kulturore, kërkojnë qasje multidisiplinare, prandaj i kemi ligjet tjera relevante si: Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare, Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale, Ligji i Policisë, shëndetësisë etj, që bashkë me rregulloret dhe mekanizmat tjerë institucionalë,

kërkojnë bashkëveprimin e plotë për të funksionuar si hallka të shtetit në adresimin e problemeve me të cilat ballafaqohemi.

Legjislacioni i arsimit, obligon institucionet përgjegjëse si: Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Komunitat, Institucionet Arsimore dhe komunitetin, që të marrin të gjitha hapat e arsyeshëm që institucionet arsimore të jenë cilësore, gjithëpërfshirëse, humane dhe të sigurta, siç e kërkojnë politikat arsimore, përfshirë standardet për shkollat mike, kurrikulat dhe secila hallkë e sistemit arsimor. Janë një varg aktesh nënligjore që ndihmojnë zhvillimin e procedurave për sigurimin e qasjes së barabartë në arsim.

Pastaj kemi dokumentet strategjike relevante që për prioritet kanë pjesëmarrjen dhe gjithëpërfshirjen në arsim si dhe dokumentet tjera strategjike ndërsektoriale dhe procedurat standarde që adresojnë aspektet e qasjes në arsim të viktimave të trafikimit, dhunës, krimit dhe rrethanave tjera çfarëdo qofshin ato.

Në funksion të zbatimit të këtyre politikave dhe konkretisht në adresimin e pjesëmarrjes në arsim ne me këtë plan komunal përqendrojmë vëmendjen te parandalimi dhe reagimi ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës, për të siguruar që të gjithë fëmijët, të jenë përfitues të sistemit arsimor dhe të zhvillohen brenda potencialit të tyre të plotë.

## Konteksti

---

Procesi mësimor në teritorin e Komunës së Lipjanit organizohet mbështetur në legjislacionin në fuqi më konkretisht në Ligjin Nr. 03/L040 për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjin Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, dhe Ligjin për Edukim në Fëmijërinë e Hershme Nr 08/L-153 sipas të cilëve asnjë personi nuk guxon t'i mohohet e drejta në shkollim.

Andaj, drejtoria Komunale e Arsimit në Lipjan ka për qëllim krijimin e kushteve për edukim cilësor të të gjithë nxënësve dhe avancim të vazhdueshëm profesional të mësimit të mësimit në përputhje me Kornizën e Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar të Kosovës.

Në bazë të raportimit nga shkollat në Komunën e Lipjanit, rezulton se në vitin shkollor 2022/2023 kanë qenë të regjistruar 11571 nxënës në të gjitha nivelet duke filluar nga niveli 0 derin në klasën e 12 të sistemuar në 24 shkolla fillore të mesme të ulëta, 3 shkolla të mesme të larta dhe një institucion parashkollor me katër paralele të ndara në katër fshatra . Nga ky numër i përgjithshëm i nxënësve 11062 janë shqiptar apo 95.6 %; 453 janë ashkalinjë apo 3.91 %; 33 janë rom apo 0.28% dhe 23 janë kroat apo 0.198%.

Duke patur parasysh që nga numri i përgjithshëm i nxënësve rreth 5 % janë nga komunitetet pakicë dhe bazuar në gjendjen jo të mirë ekonomike-financiare, sociale dhe vështërsive të tjera janë raportuar gjithsejt 69 nxënës që kanë braktisur shkollimin.

Po ashtu janë raportuar 181 nxënës me një prind apo asnjërin prind si dhe 85 nxënës me aftësi të kufizuara.

Me qëllim të përkrahjes profesionale të shkollave ku janë të punësuar 1022 mësimit prej të cilëve 459 meshkuj dhe 563 femra, DKA ka punësuar edhe 5 psikologe shkollore, 1 logopede , 5 asistent për fëmijë me aftësi të kufizuara, dy mësues mbështetës si dhe janë përkrahur 4 Qendra mësimore për mësimit plotësues kryesisht për nxënësit e komunitetit pakicë, në bashkëpunim me OJQ, të cilat bashkëpunojnë ngusht me Ekipin Komunal të Vlerësimit.

Megjithatë, për shkak se DKA ballafaqohet me mungesë të stafit të mjaftueshëm, dhe vështirësi tjera administrative e ligjore, atëherë kjo situatë e vështirëson funksionimin e EPRBM-së komunale dhe atyre shkollore.

Gjithashtu në shumicën e shkollave funksionaliteti i ekipeve të EPRBM-ve ballafaqohet me sfida të shumta, të cilat përfshijnë natyrën e punës në teren, koordinimin e domosdoshëm ndërinstitutional, trajnimet e vazhdueshme të ekipeve, takimet me prindër dhe nxënës e shumë angazhime të tjera, të cilat kanë edhe implikime buxhetore.

Edhe pse Ligji Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovë parasheh arsimin e detyrueshëm (Shkollimi i detyruar fillon në fillim të vitit shkollor pas datës kur fëmija arrin moshën gjashtë (6) vjeçare që është moshë minimale për shkollimin e detyruar dhe përfundon në fund të nivelit 2 të ISCED), te rastet e braktisjes zbatimi i tij në praktikë hasë në vështirësi për shumë arsye.

Me qëllim të funksionimit sa më të mirë të këtyre EPRBM-ve, grupi punues në nivel komune ka hartuar draftplanin komunal të veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit në shkollës 2024-26 në të cilin përfshihen një sërë aktivitete.



## Qëllimi i planit të punës

---

Koordinimi i veprimeve ndërinstitucionale dhe ngritja e kapaciteteve në nivel lokal dhe shkollor në zbatim të detyrimeve ligjore për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës, duke rritur përfshirjen e fëmijëve në arsim dhe zvogëlimin e braktisjes.

## Objektivat e Planit Komunal të Veprimit

---

- **Objektiva e përgjithshme I:** Parandalimi dhe Identifikimi i hershëm i nxënësve në rrezik të braktisjes dhe ofrimi i ndërhyrjeve të duhura për t'i mbështetur ata, si këshillim, mbështetje dhe mentorim

### Objektivat specifike:

- 1.1 Fuqizimi i EPRBM-ve komunale dhe shkollore, si dhe monitorimi i vazhdueshëm i braktisjes në nivel komune;
- 1.2 Koordinimi ndërinstitucional dhe me partnerë zhvillimorë në mbështetjen e aktiviteteve të shkollave;
- 1.3 Monitorimi i progresit akademik dhe joakademik i nxënësve dhe t'u ofrohet atyre mbështetje kur është e nevojshme.

- **Objektiva e përgjithshme II:** Ulja e përqindjes së braktisjes së shkollës duke krijuar një tranzicion të lehtë nga shkolla e mesme e ulët në shkollën e mesme të lartë, bazuar në mundësitë e karrierës që përputhen me aftësitë, dhe interesat e nxënësve

### Objektivat specifike:

- 2.1. Urëzimi mes shkollës së mesme të ulët me shkollën e mesme të lartë duke filluar nga klasa e 6-të;
- 2.2. Ndërgjegjësimi i prindërve dhe nxënësve për orientimin në profile sipas kompetencave dhe interesave të fëmijës;

2.3. Krijimi i partneriteteve me bizneset lokale për të ofruar mundësi të punës praktike, programe të mentorimit dhe mundësi për krijimin e vendeve të punës

2.4. Monitorimi i zbatimit të planit të veprimit.

Këto objektiva janë detajuar me aktivitete, indikatorë, afate kohore, institucione përgjegjëse dhe mbështetëse, si dhe me buxhetin e planifikuar, ashtu që lehtësisht monitorohen në faza periodike.

**Rezultatet kryesore të pretenduara:**

- Rritja e monitorimit dhe mbikëqyrjes nga inspektorati
- Fuqizimi i EPRMB në Komunë dhe në të gjitha shkollat
- Në fund të secilit vit pretendojmë rezultate konkrete për numrin / përqindjen e rasteve të zgjidhura
- Përgjigjja ndaj rasteve të nxënësve të panotuar dhe me shumë mungesa
- Rritja e raportimit cilësor nga shkollat/ zvogëlimi i braktisjes

**Buxhetimi:**

Buxheti i paraparë në këtë plan arrin deri në 23.600.00€ .

**Monitorimi:**

Zbatimin e këtij plani e monitoron EPRBM komunale, e cila bënë raport vjetor mbi zbatimin e planit. Ky plan veprimi do të shoqërohet me kornizë monitoruese, e cila do ta lehtësojë procesin e monitorimit dhe raportimin në afatet e përcaktuara, gjashtëmujore dhe vjetor

Objektiva e përgjithshme 1. Fuqizimi i EPRBMve për parandalim dhe identifikim të hershëm të nxënësve në rrezik të braktisjes dhe ofrimi i ndërhyrjeve të duhura për t'i mbështetur ato, si këshillim, mbështetje dhe mentorim						
Objektiva specifike 1.1: Funkcionalizimi i EPRBMve komunale dhe shkollore, si dhe monitorimi i vazhdueshëm i braktisjes në nivel komune						
Nr.	Aktivitetet	Treguesit	Afati kohor			Buxheti
			2024	2025	2026	
1.1.1	Fuqizimi i EPRBM-së komunale me takime dhe raportime të rregullta	Vendimi, procesverbalet, Agjendat Takimet	Shtator - nëntor			1500.00 €
1.1.2.	Ekipet e EPRBM në të gjitha shkollat e parauniversitar janë të themeluara	Vendimet e EPRBM-ve shkollore me procesverbalet dhe anëtarët e ekipeve në 27 shkolla janë të raportuara të cilat do të rifunksionalizohen në shkollat ku ka lëvizje të anëtarëve të ekipit	Shtator - nëntor			0.00
1.1.3	Seanca mbështetëse për EPRBM-në komunale. Takime informuese	Agjendat, listat e pjesëmarrjes me ekspert të jashtëm nga MASHT/OJQ (trajtime)	x	x	x	1500.00€

Plani komunal i veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës 2024-26

1.1.4	Seanca mbështetëse për EPRBM-të shkollore	Agjendat, listat e pjesëmarrjes 4 takime minimalisht në vit Organizimi i trajnimeve për ekipet EPRBM-ve shkollore Sigurimi i materialeve për organizimin aktiviteteve	x	x	x	DKA	MASHTI Partnerët	Donatorët 1500.00 €
1.1.5.	Asistimi i EPRBM-ve shkollore për përdorimin e SPH-së (sisitemi i paralajmërimit të hershëm)	Nr. i takimeve, nr. i shkollave përftuese Angazhimi i studentëve të fushës në përkrahjen e ekipeve shkollore (organizimi transportit dhe shpenzimeve tjera)	x	x	X	DKA	MASHTI Partnerët	1500.00€
<b>Objektiva specifike 1.2: Koordinimi ndërinstitucional dhe me partnerë zhvillimor në mbështetjen e aktiviteteve të shkollave dhe nxënësve në nevojë</b>								
	<b>Aktivitetet</b>	<b>Treguesit</b>	<b>Afati kohor</b>			<b>Buxheti</b>		

		2024	2025	2026	Institucioni përgjegjës	Institucionet mbështetëse	
1.2.1	Takime koordinuese me partnerë	x	x	x	DKA	MASHTI Partnerët	600.00€
	Nr. i takimeve, që do të realizohen me partnerë minimalisht 2 brenda vitit Rezultatet: përpunimi i të dhënave ekzistuese për numrin e braktisjeve; koordinimi i aktiviteteve vetëdijësuese për regjistrim në shkolla						
1.2.2	Zhvillimi i projekteve ndërsektoriale (zyra për komunitete, qps, zyra e kryetarit, DKA) në parandalim të dukurive negative që e sfidojnë vijimin e rregullt të shkollës të gupeve të caktuara të ndënësve	Tetor-nëntor	Tetor - nëntor	Tetor - nëntor	DKA	Drejtoritë tjera komunale Partnerët	3000.00€
	Nr. i projekteve, aktiviteteve ndërjegjësuere (3 projekte për tri vite) Nr. i shkollave përfutuese (8 shkolla) Nr. i nxënësve për fitues (varësisht nga raportet e shkollave)						
1.2.3	Mbështetja e nxënësve dhe stimulime tjera (shpërblime) për motivimin e shkollimit të qëndrueshëm.	x	x	x	Kuvendi Komunal Donator	Partnerët	1000.00€
	Përkrahje financiare (pako mbështetëse ose subvencionim) të identifikuar nga ekipi dhe shkolla Nr. i nxënësve përfutues – sipas nevojës						

	Muaji solidaritetit											
1.2.4.	Fushatë vetëdijësimi për regjistrimin e fëmijëve në klasa parafillor dhe klasëve të para	Prill -maj	x	x	x				DKA	Donator		1500.00€
<b>Objektiva specifike 1.3: Monitorimi i progresit akademik dhe joakademik i nxënësve dhe t'u ofrohet atyre mbështetje kur është e nevojshme.</b>												
	<b>Aktivitetet</b>	<b>Treguesit</b>	<b>Afati kohor</b>			<b>Institucioni përgjegjës</b>	<b>Institucionet mbështetëse</b>	<b>Buxheti</b>				
			2024	2025	2026							
1.3.1.	Zhvillimi i një sistemi të regjistrimit kumulativ për nxënësit e klasave 6-9	Regjistri i zhvilluar. Evidencat	x	x	x	Masht DKA shkollat	MASHTI Partnerët	0.00€				
1.3.2.	Sigurimi i trajnimeve për mësuesit dhe administratorët e shkollave se si të mirëmbajnë dhe përdorin sistemin e regjistrimit kumulativ;	Trajnimet e zhvilluara	Në muajin nëntor dhe në muajin prill	Në muajin nëntor dhe në muajin prill	Në muajin nëntor dhe në muajin prill	DKA MASHTI	Partnerët	0.00€				
1.3.3	Takimet e rregullta me prindërit, mësuesit dhe administratorët e shkollave për të rishikuar përparimin akademik dhe joakademik të nxënësve	Takimet e realizuara	x	x	x	Shkollat	DKA	0.00€				

Plani komunal i veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës 2024-26

	nga kryetari i komunes ose vartësit e tijë									
1.3.4	Sigurimi i fondeve për aktivitetet mbështetëse për nxënësit që kanë vështrësi akademike ose personale;	Buxheti i ndarë	x	x	x	DKA shkollat	MASHTI MEF	1000.00€		
1.3.5.	Zbatimi i sistemit kombëtar për identifikimin dhe adresimin e faktorëve të rrezikut për braktisjen e shkollës, si mungesat në shkollë, performancë e dobët akademike dhe çështjet e sjelljes.	SPH funksional dhe i përdorshëm nga të gjitha shkollat	x	x	x	Shkollat DKA	MASHTI Partnerët	0.00€		
Objektiva e përgjithshme 2. Ulja e përqindjes së e braktisjes së shkollës duke krijuar një tranzicion të lehtë nga shkolla e mesme e ulët në shkollën e mesme të lartë, bazuar në mundësitë e karrierës që përputhen me aftësitë, dhe interesat e nxënësve.										
Objektiva specifike 2.1: Urëzimi mes shkollës së mesme të ulët me shkollën e mesme të lartë duke filluar nga klasa e 6-të										
Nr.	Aktivitetet	Treguesit	Afati kohor			Institucioni përgjegjës	Institucionet mbështetëse	Buxheti		
			2024	2025	2026					

Plani komunal i veprimt kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës 2024-26

2.1.1	Zbatimi i politikave për orientimin në karrierë në fazat e hershme dhe me fokus për nxënësit e klasës së 6-të.	U.A i zbatueshëm Aktivitet e rregullta, të realizuara	x	x	x	x	Shkollat DKA	MASHTI Partnerët	
2.1.2.	Organizimi i panairëve të karrierës për t'i ekspozuar nxënësit para profesioneve të ndryshme dhe mundësi punësimit.	Panairët e realizuara Këshilla grupore dhe individuale, identifikimi i nevojave Transferimi i nxënësve nga SHFMU-të në SHML (Dyert e hapura)	x	x	x	x	Shkollat DKA	MASHTI Partnerët	1500.00€
2.1.3	Angazhimi i këshilltarëve për orientimin në karrierë në shkollat e mesme të ulëta për t'u ofruar nxënësve këshilla dhe mbështetje profesionale.	Nr. i këshilltarëve të karrierës të punësuar në shkolla Numri i këshilltarëve sipas dispozitave ne UA	x	x	x	x	DKA	MASHTI	Kosultimi i udhëzimit për këshilltare të karrieres
2.1.4	Hartimi i një programi që i ndihmon nxënësit në planifikimin e karrierës dhe vendimmarrjen, i cili	Programi i hartuar dhe i shpërndarë në shkolla, postera, flajëra, fletëpalosje Mësimdhënësit që	x	x	x	x	Shkollat DKA	MASHTI Partnerët	1500.00€



Aktivitetet	Treguesit	Afatit kohor			Institucioni përgjegjës	Institucionet mbështetëse	Buxheti	
		2024	2025	2026				
<p><b>Objektiva specifike 2.2: Ndërgjegjësimi i prindërve dhe nxënësve për orientimin në profile sipas kompetencave dhe interesave të fëmijës</b></p>								
<p>përfshin lidhjen e tyre me shkollat e mesme të larta.</p>	<p>ligjërojnë lëndën: orientim në karrierë në kuadër të lëndëve zgjedhore</p>							
2.2.1	<p>Përgatitja e materialeve informuese për prindër dhe nxënës.</p>	<p>Materialet e përgatitura</p> <p><b>Videomesazhe</b></p>	x	x	x	<p>Shkollat</p> <p>DKA</p>	<p>MASHTI</p> <p>Partnerët</p>	1500.00€
2.2.2	<p>Punëtori me prindër për promovimin e profileve arsimore dhe përparësitë e orientimit të saktë të fëmijëve në shkollimin e mesëm.</p>	<p>Nr. i punëtorive, takimeve të realizuara</p> <p>Së paku 1 punëtori në vit në të gjitha shkollat (27)</p>	x	x	x	<p>Shkollat</p> <p>DKA</p>	<p>MASHTI</p> <p>Partnerët</p>	1500.00€
2.2.3	<p>Seminare për nxënësit e shkollave të mesme të ulëta për të eksploruar aftësitë, interesat dhe aftësitë e tyre.</p>	<p>Nr. i seminareve të realizuara me nxënës</p> <p>Këshilltari i karrieres</p> <p>seminare me klasat 6,7,8,9 në kordinim me UA</p>	x	x	x	<p>Shkollat</p> <p>DKA</p>	<p>MASHTI</p> <p>Partnerët</p>	0.00

2.2.3.	Takime të përbashkëta me prindër, nxënës me folës motivues.	Numri i takimeve të realizuara	x	x	x	Shkollat	MASHTI Partnerët	0.00	
									DKA
<p><b>Objektiva specifike 2.3. Krijimi i partneriteteve me bizneset lokale për të ofruar mundësi të punës praktike, programe të mentorimit dhe mundësi për krijimin e vendeve të punës.</b></p>									
Aktivitetet	Treguesit	Afati kohor			Institucioni përgjegjës	Institucionet mbështetëse	Buxheti		
		2024	2025	2026					
2.3.1. Identifikimi i bizneseve dhe krijimi i marrëveshjeve të mirëkuptimit për shkollat profesionale	Nr. i marrëveshjeve dhe i partnerëve (sa është kerkesa/nevoja)	30	50	60	Shkollat DKA	MASHTI Partnerët	1500.00		
2.3.2. Zbatimi i marrëveshjeve të mirëkuptimit sipas përgjegjëseve të ndara. Trajnimi i personelit mesimor Ushtrime me nxënës për aftësi të buta Realizimi i mësimit në vendin e punës Realizimi i mësimin dual. Marketingu i shkollës (i profileve dhe	Nr. i shkollave dhe profileve përfituese të marrëveshjeve (nr. shkollave, transporti i këtyre nxënësve) Nr. i nxënësve që mbështeten për punën praktike. Rritja e interesimit të nxënësve për drejtimet teknike Takime me nxënës të klasave 9 Shperndarja e fletëpalosjeve dhe	x	x	x	Shkollat DKA	MASHTI Partnerët	3000.00€		

	aktivitetet që realizohen në shkollë)	postereve për ti motivuar nxënësit të regjistrohen në shkollën tonë, Mirëmbajtja, postimet, sponsorizimi i aktiviteteve që realizon shkolla me nxënësit në mediat sociale							
2.3.3									
<b>Objektiva specifike 2.4. Monitorimi i zbatimit të planit të veprimit</b>									
Aktivitetet	Treguesit	Afati kohor			Institucioni përgjegjës	Institucionet mbështetëse	Buxheti		
		2024	2025	2026					
2.4.1.	Zhvillimi dhe aprovimi i kornizës monitoruese	x	x	x	DKA - Shkollat	MASHTI Partnerët	0.00€		
2.4.2.	Mbledhja e të dhënave sipas kornizës monitoruese	x	x	x	DKA Shkollat	MASHTI Partnerët	0.00€		
2.4.3	Analiza e të dhënave	x	x	x	DKA Shkollat	MASHTI Partnerët	0.00€		
2.4.4.	Raportimi mbi zbatimin e planit të veprimit	x	x	x	DKA Shkollat	MASHTI Partnerët	0.00€		
2.4.5.	<b>Matja e progresit të zbatimit të planit të veprimit</b>	x	x	x	DKA Shkollat	MASHTI Partnerët	0.00€		